



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
FIER

Lagjja "29 Nëntori", Rruga "Todi Shkurta"

Nr. 5951 i prot.

Fier, më datë 24.07.2023

**SHPLLJE**

**PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE "NËPUNËS I TEKNOLOGJISË DHE  
INFORMACIONIT"**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Gjykata e Shkalës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

**I (një) pozicion – Specialist i Teknologjisë së Informacionit, kategoria IV-2.**

*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga keto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende vakant, ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

**07 Gusht 2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

**14 Gusht 2023**

**Përshtkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Specialist i Teknologjisë së Informacionit është:**

**IV. DETYRA KRYESORE**

Nëpunësi civil gjyqësor, specialist i teknologjisë së informacionit ushtron në veçanti këto kompetenca:

- a) zbaton aktet normative nënligjore në fuqi lidhur me teknologjinë e informacionit;
- b) mirëmban sistemin ekzistues të kompjuterave në drejtim hardëare dhe softëare kryen kontroll periodik mujor të gjendjes së pajisjeve elektronike të gjykatës si dhe backup periodik, zakonisht ditor, të të dhënave sensitive, databazës së sistemit të të dhënave ARKIT, së sistemit audio RDA, si dhe arkivit qendror të transfertës së gjyqtarëve;
- c) bashkëpunon dhe mban lidhje me sektorët dhe eprorët përkatës për problemet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në konfigurimin e-mail, serverit të brendshëm si dhe domain-it të gjykatës, krijimin e përdoruesit e gjykatës (kryetar, kancelar, gjyqtar, sekretarë, etj.), korrigjimin e gabimeve të bëra nga përdoruesit me lejen e eprorit të gjykatës, pajisjen e çdo nëpunës civil gjyqësor të gjykatës me akseset e nevojshme në sistemet elektronike, në përputhje me detyrat e punonjësit; kopjimin e CD-ve audio të dosjeve të dorëzuara nga sekretarët; ndërhyrjen në sistem për ndryshimin e seksionet e gjyqtarëve në bazë të urdhrat të nxjerrë nga Kryetari I Gjykatës, Këshilli i Gjykatës;
- ç) monitoron, administron dhe mirëmban infrastrukturën kompjuterike dhe informatike në gjykatë me anë të operacioneve periodike për të garantuar funksionimin e tyre normal, përfshirë këtu (por duke mos u kufizuar me to) testimin e pajisjeve, monitorimin, përditësimin, dhe kryerjen e kopjeve rezervë dhe raporteve, etj.,-gjurmimin e çdo veprimi të kryer nga përdoruesit e sistemit si dhe të ngarkesës së gjyqtarëve që marrin pjesë në short;
- d) ofron mbështetje për gjyqtarët si dhe nëpunësit civil gjyqësor pa vonesë në raste kërkesash për problemet kompjuterike për gjykatën;
- dh) mirëmban dhe mbështet infrastrukturën informative të gjykatës: rrjetin e brendshëm kompjuterik (LAN/ËAN) dhe siguron komunikimin e të dhënave;
- e) përditëson faqen zyrtare të gjykatës me informacionet më të fundit në bashkëpunim me sektorët e tjerë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: afishimin e listave të gjykimeve në faqen e gjykatës, ndalimin e publikimit e dosjeve me të dhëna tepër sensitive, siç është birësimi, etj, në faqen e gjykatës;
- ë) harton dhe zbaton politikën e sigurisë informative të gjykatës duke instaluar, konfiguruar, dhe mirëmbajtur sisteme kundër programeve dashakeqëse, ndërhyrëse (mure mbrojtës, antiviruset, etj.) të tilla si instalimin, konfigurimin dhe troubleshooting e kompjuterëve dhe netëorkut të gjykatës; mbrojtjen e të dhënave të brendshme nga infiltrimi i jashtëm përmes enkriptimit, ruajtjes së sigurtë të të dhënave, instalimit të antivirusëve dhe softeve anti spam, dhe mjeteve të tjera të nevojshme;
- f) ofron udhëzime dhe trajnime për stafin e gjykatës, sipas nevojës, për përdorimin e programeve që përdoren;
- g) harton dhe monitoron respektimin e standardeve të teknologjisë së informacionit që janë tepër të rëndësishme për integritetin, sigurinë dhe performancën e infrastrukturës teknike të gjykatës;
- gj) mbikëqyr zbatimin dhe performancën e të gjitha nismave që gjykata ndërmerr në lidhje me teknologjinë; zhvillon, për aq sa është e mundur, procedura të reja të IT-së për të rritur efikasitetin dhe për të lehtësuar punën e punonjësve të gjykatës;
- h) bashkëpunon me sektorë të tjerë të gjykatës statistika për raportimet për qëllime të ndryshme sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
- i) ndërton dhe mirëmban një sistemi elektronik të brendshëm të statistikave të kategorive të ndryshme të të dhënave në bashkëpunim me nëpunësit civil gjyqësor

- përkatës: të dhënat volumetrike, të inventarit dhe të përpunimit për efekt të matjes së performancës së gjykatës dhe nëpunësve civil të saj;
- j) mban kontakte me kompanitë kontraktore që ofrojnë shërbime të ndryshme suporti si, shërbimi i printimit, shërbimi i audios, si dhe shërbimi i internetit;
  - k) harton, sipas rastit edhe në bashkëpunim me nëpunësin civil gjyqësor të prokurimeve publike, specifikimet teknike të pajisjeve elektronike të gjykatës;
  - l) kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me teknologjinë e informacionit apo statistikat që i caktohet nga kancelari dhe/ose Këshilli i Gjykatës.

## **I. LËVIZJA PARALELE**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.*

### **I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brënda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë".

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Të jetë i/e diplomuar në Inxhinieri Informatike, Teknologji e Informacionit, Informatike në nivelin "Master Shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- b) Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoja tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
- c) Aftësi të tjera: Të ketë certifikime profesionale në fushën e IT;
- d) Të zotërojë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;
- e) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërveprimi.

### **I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
  - CV e përditësuar.
  - Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
  - Fotokopje të librezës së punës.
  - Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
  - Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
  - Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
  - Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
  - Fotokopje e kartës së identitetit.
  - Vërtetim banimi.
  - Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda datës 07 Gusht 2023, ora 16:00, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ose nëpërmjet shërbimit postar në adresën : Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Lagjja “29 Nëntori”, Rruga Todi Shkurta”, Fier.

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

### **I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

### **I.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Vlerësimi profesional** për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas një sistemi pikëzimi.

**Kandidatët do të vlerësohen:**

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

### **I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

## **II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta marrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës.*

### **II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA**

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të

shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- f) Të jetë i/e diplomuar në Inxhinieri Informatike, Teknologji e Informacionit, Informatike në nivelin “Master Shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjisllacionit të arsimit të lartë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- g) Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
- h) Aftësi të tjera: Të ketë certifikime profesionale në fushën e IT;
- i) Të zotërojë mirë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;
- j) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërveprimi.

**II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
  - CV e përditësuar.
  - Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
  - Fotokopje të librezës së punës.
  - Fotokopje të certifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
  - Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
  - Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
  - Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
  - Fotokopje e kartës së identitetit.
  - Vërtetim banimi.
  - Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda datës 14 Gusht 2023, ora 16:00, në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ose nëpërmjet shërbimit postar ne adresën : Gjykata së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Lagjja “29 Nentori”, Rruga Todi Shkurta”, Fier.

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

**II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

KLJGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

#### **II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- a. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,
- b. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Ligji nr.9880 , datë 25.02.2008”Për nënshkrimin Elektronik” I ndryshuar
- d. Ligji nr.10325, datë 23.09.2010”Mbi bazat e të dhënave shtetërore”.
- e. Ligji nr.9887 datë 10.03.2008”Për mbrojtjen e të dhënave personale” I ndryshuar
- f. Ligji nr.9918 datë 19.05.2018”Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

#### **II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen:**

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b.40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLJGJ dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier do të shpallë fituesin në faqet zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLJGJ dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

## ***KËSHILLI I GJYKATËS***